

NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË PARË PUBLIK

Përmbareuesi Privat **Driton Govori**, më datë 20.10.2020 ka sjellë Konkluzion për lëndën **P.nr.316/17**, mbi shitjen e paluajtshmërisë të hipotekuar në favor të bankës BKT, të evidentuar në Çertifikatën e Pronës me numër **011-953-101443-2015**, parcela me numër **P-71914066-00528-0**, me sipërfaqe prej **3646 m²**, Zona Kadastrale Sofali, Komuna Prishtinë, e evidentuar në emër të pronarit z.Orhan Basha, e bllokuar/hipotekuar në favor të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.

Kjo pasuri e përshkruar më lartë do të shitet përmes Ankandit të Parë Publik, në mbështetje të plotë të dispozitës së Nenit 227 të LPP-së, me qëllim të sigurimit të mjeteve për të përmbushur detyrimet që debitorët Kompania “R & F” SH.P.K (dhe të tjerët) kanë ndaj kreditorit – **Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.**

» Vlera e paluajtshmërisë është vlerësuar në shumën prej: **54,000.00 €** (pesëdhjetë e katër mijë) Euro, pasuri e cila në këtë ankand të parë të shitjes publike mund të shitet nën vlerën e përcaktuar, por jo nën 50% të vlerës së përcaktuar.

- Data e Ankandit të Parë Publik: **20.11.2020**
- Koha e shitjes – ora: **10:00**
- Vendi i shitjes: **Përmbareuesi Privat Driton Govori, me adresë: Dëshmorët e Kombit D1, H-7, Nr.9, Prishtinë.**

Të gjithë të interesuarit duhet të deponojnë tek Përmbareuesi Privat shumën prej 10 % të vlerës së cekur të paluajtshmërisë por jo më shumë se 5,000 Euro në emër të kaucionit, para se të fillojë shitja, por jo më vonë se data 19.11.2020, me të drejtë të kthimit të kaucionit pas përfundimit të ankandit, ofertuesve të pasuksesshëm.

Për informata me të hollësishme, ju lutem, kontaktoni në tel: 038 666 666; 045/700-790;

Prishtinë, 2020



038 666 666 | www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu!